

Gzim Rushiti, MA¹

UDC: 327.51(100-622HATO:497-15)

**NATO DHE RELACIONET ME BALLKANIN PERËNDIMOR
(RASTI I BOSNJËS, KOSOVËS DHE MAQEDONISË SË VERIUT)**

**НАТО И ОДНОСТИЕ СО ЗАПАДЕН БАЛЛКАН
(СЛУЧАЈ НА БОСНА, КОСОВО И СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА)**

**NATO AND RELATIONS WITH THE WESTERN BALKANS
(CASE OF BOSNIA, KOSOVO AND NORTH MACEDONIA)**

Abstract

NATO was born in the years after World War II, to respond to the great political, economic and military pressure of the Soviet Union on Western democracies. NATO is legally established as an Alliance of independent states, who had as their common interest the preservation of national and world peace and security. The NATO Treaty was signed in Washington in 1949 and entered into force the same year. NATO's relations with the Balkans date back to the beginning of the Cold War. Following the fall of the Berlin Wall, the dissolution of the Soviet Union and the Warsaw Pact Bloc, and the dissolution of the former Yugoslavia, the Balkan countries declared NATO integration their strategic priority. One of the first and most serious challenges that NATO faced after the fall of the Berlin Wall was the Balkan crisis. Western military involvement in general and NATO - in the Bosnian conflict - began quickly. NATO used military intervention as a last resort to resolve the conflict in Kosovo after a period of widespread escalation of violence, repression and human rights abuses by Serbia

¹ Autori është student në studimet e Ciklit të tretë në Fakultetin Juridik në Manastir në Universitetin "Shën Klimenti i Ohrit", drejtimi - E drejta ndërkombëtare dhe politika ndërkombëtare. Email: ge-zim1990@hotmail.com

against the civilian population in Kosovo. NATO's relations with the Republic of North Macedonia starting from 1993 until today have their own special history, which includes a chronological period of almost thirty years, relations which reached their culmination on March 20, 2020 with the full membership of the Republic of Northern Macedonia in NATO as the thirtieth member state of the Alliance.

Historia dhe qëllimet e krijimit të NATO-s

NATO lindi në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore. Nga viti 1945-1949, krijimi i NATO-s u diktua nga rrethanat e presionit të madh politik, ekonomik dhe ushtarak të Bashkimit Sovjetik mbi demokracitë perëndimore. Imponimi i regjimeve jo demokratike, detyrimi i modelit sovjetik mbi vendet e Evropës Lindore, shtrirja e strukturave të Ushtrisë së Kuqe në tërë zonën e regjimeve komuniste dhe politika e jashtme ofensive, përbënin kërcënim real për paqen, demokracinë dhe zhvillimin ekonomik të Evropës Perëndimore.

Nga vitet 1947 deri 1949, tendenca kërcënuese e Bashkimit Sovjetik mori pamje konkrete në ngjarje të tilla si kërcënim i sovranitetit të Norvegjisë, të Greqisë e Turqisë si dhe i vendeve të tjera perëndimore, grushti sovjetik i shtetit në 1948 në Çekosllovakia, bllokimi ilegal i Berlinit në prill 1948, në tërësi i detyruan pesë shtetet evropiane perëndimore të firmosnin Traktatin e Brukselit të marsit 1948, i cili shprehte vendosmërinë e Belgjikës, Francës, Luksemburgut, Holandës dhe Britanisë së Madhe për krijimin dhe zhvillimin e një sistemi mbrojtjeje të përbashkët, të aftë për të përballuar kërcënimet ideologjike, politike dhe ushtarake.

Traktatin e Brukselit e vijuan negociatat me Shtetet e Bashkuara dhe Kanadanë dhe çuan në krijimin e Aleancës së Atlantikut të Veriut, bazuar në garancitë e sigurimit dhe të angazhimit të përbashkët midis Evropës dhe Amerikës së Veriut.²

Aleanca Veri-Atlantike (NATO) është themeluar më 4 prill të vitit 1949, kur përfaqësuesit e SHBA-së, Kanadasë, Francës, Britanisë së Madhe, Italisë, Belgjikës, Norvegjisë, Holandës, Portugalisë, Danimarkës, Luksemburgut dhe Irlandës e kanë nënshkruar Marrëveshjen Evropo-atlantike, e cila hyri në fuqi më 24 gusht 1949. Në bazë të kësaj Marrëveshjeje NATO është krijuar juridikisht si një aleancë e shteteve të

² Lisen Bashkurti. Mbi të Drejtën Ndërkombëtare dhe Organizatat Ndërkombëtare, Akademia Diplomatike Shqiptare, GEER, Tiranë, 2006, f. 148.

pavarura, të cilët si interes të përbashkët kishin ruajtjen e paqes dhe të sigurisë nacionale dhe botërore.

Krijimi i Aleancës Veri-Atlantike është bërë në pajtim me nenin 51 të Kartës së OKB-së, ku konfirmohet e drejta e pakontestueshme e shteteve në mbrojtjen individuale dhe kolektive.

Në fakt, krijimi i Aleancës ishte pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për të shërbyer tri qëllime :

1. Që të largonin ekspansionizmin sovjetik.
2. Të ndalon ringjalljen e militarizmit nationalist në Evropë përmes pranisë së Amerikës së Veriut në kontinent.
3. Duke inkurajuar integrimin politik evropian.³

Sipas Traktatit të Atlantikut të Veriut qëllimet e palëve kontraktuese të këtij traktati janë :

Palët e këtij Traktati ripohojnë besimin e tyre në qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe dëshirën e tyre për të jetuar në paqe me të gjithë popujt dhe me të gjitha qeveritë.

Ato janë të vendosura të ruajnë lirinë, trashëgiminë e përbashkët dhe qytetërimin e popujve të tyre, të ngritura mbi parimet e demokracisë, të lirisë së individit dhe të rendit ligjor.

Ato synojnë të rritin më lartë stabilitetin dhe mirëqenien në zonën e Atlantikut të Veriut.

Ato janë të vendosura të bashkojnë përpjekjet e tyre për mbrojtje të përbashkët dhe për ruajtjen e paqes e të sigurisë. Për rrjedhojë ato pajtohen me këtë Traktat të Atlantikut të Veriut.⁴

Traktati i NATO-s u nënshkrua në Uashington në 1949 dhe hyri në fuqi të njëjtin vit.⁵

Strukturat ose organet e NATO-s

Struktura e NATO-s është e ndarë në dy pjesë:

1. Pjesa që përbëhet prej organeve civile
2. Pjesa që përbëhet prej organeve ushtarake.⁶

³ Drita M. Fazlia, Organizatat Ndërkombëtare, Arbëria Design-Tetovë, Tetovë, 2014, f, 187.

⁴ Traktati i Atlantikut të Veriut, Uashington D.C., 4 prill 1949.

⁵ Gjorgji Tonovski. Organizatat Ndërkombëtare, Universiteti Evropian - RM, Shkup, Fakulteti i Shkencave Juridiko-Politike, Shkup, 2006, f, 193.

⁶ Arif Riza, E drejta e organizatave ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare, Botimi I, Prishtinë, 2012, f, 282.

Relacionet e NATO-s me Ballkanin gjatë luftës së ftohtë

Marrëdhëniet e NATO-s me Ballkanin kanë nisur shumë herët, qysh në fillimet e Luftës së Ftohtë.⁷ Zgjerimi i parë i Aleancës menjëherë pas 12 anëtarëve të saj themelues u bë pikërisht në drejtim për dy vende ballkanike: Turqia dhe Greqia në vitin 1952. Për këta dy vende ky hap ishte i një rëndësie të jashtëzakonshme për t'u shkëputur nga rreziku sovjetik dhe për të fuqizuar sigurinë Euroatlantike nga Joni deri në kufijtë lindorë të Turqisë afër kufirit të ish-Bashkimit Sovjetik.⁸

Relacionet e NATO-s me Ballkanin pas luftës së ftohtë

Pas rënies së Murit të Berlinit, shpërbërjes së BRSS dhe të Bllokut të Traktatit të Varshavës, vendet e Ballkanit (Bullgaria, Rumania dhe Shqipëria) apo edhe të dala nga shpërbërja e Jugosllavisë (Sllovenia, Kroacia dhe Maqedonia) shpallën përparësi strategjike të tyre integrimin në NATO.

Në Samitin e Brukselit në vitin 1994, NATO miratoi nismën e Partneritetit për Paqe. Kështu gjithë vendet e lartpërmendura ishin ndër të parat që u përfshinë në Programin Individual të Partneritetit për Paqe.⁹

Programi i Partneritetit për Paqe e ka ndihmuar tranzicionin e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, përmes reformimit të forcave ushtarake, të marrëdhënieve civile-ushtarake, dhe doktrinës dhe ushtrimeve paqeruajtëse me kombet e NATO-s, duke demonstruar në praktikë si mund t'i përkrahë ushtria institucionet demokratike. Lidhur me këtë, një vlerë të spikatur e kishin Programet e hollësishme individuale të Partneritetit që u implementuan pasi që për to ishte arritur marrëveshja. PFP ka pasur një ndikim mbresëlënës në trajtimin e kulturave të politikave të jashtme të shumë prej shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore, përmes promovimit të marrëdhënieve të mira fqinjësore, të transparencës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe të konsultimeve përmes Brukselit.¹⁰

⁷ Lisen Bashkurti. Mbi të Drejtën Ndërkombëtare dhe Organizatat Ndërkombëtare, Akademia Diplomatike Shqiptare, GEER, Tiranë, 2006, f, 167.

⁸ Bejtush Gashi, Pjetër Hidri, Konfliktet ndërkombëtare dhe ndëretnike, Prishtinë, 2008, f, 58.

⁹ Bejtush Gashi, Pjetër Hidri, Konfliktet ndërkombëtare dhe ndëretnike, Prishtinë, 2008, f, 58.

¹⁰ Lulzim Peci, Kosova në kontekstin e sigurisë dhe të mbrojtjes të Ballkanit Perëndimor, Punim i politikave, Nr. 3/14 - Shtator 2014, KIPRED, Instituti Kosovar për

Në Samitin e Uashingtonit 1999 u miratua Plani i Anëtarësimit në NATO (Membership Action Plan). Në këtë plan u përfshinë menjëherë edhe këto vende të Ballkanit: Shqipëria, Bullgaria, Rumania, Sllovenia dhe Maqedonia.

Në Samitin e Pragës 2002, tre vende të Ballkanit: Sllovenia, Bullgaria dhe Rumania u pranuan anëtare të NATO-s, ndërsa Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia vijuan në projektin e MAP-it.¹¹

NATO dhe kriza e Ballkanit

Kriza jugosllave, e cila shpërtheu pas rënies së Murit të Berlinit në 1989, do të identifikojë termin krizë në Ballkan dhe do të detyrojë strategët Euro-Atlantikë dhe të KB të merren me menaxhimin e krizave në ish-Jugosllavi.¹²

Një nga sfidat e para dhe serioze me të cilat u ndesh NATO pas rënies së Murit të Berlinit ishte kriza e Ballkanit, ose e njohur ndryshe si kriza e ish-Jugosllavisë. Kjo krizë kishte filluar disa vite pas vdekjes së Titos.

Kriza e ish-Jugosllavisë angazhoi të gjithë faktorët më të rëndësishëm ndërkombëtarë si OKB, OSBE, BE, KE deri te Aleanca e Këshillit të Atlantikut Verior.

Situata tepër e nderë që ekzistonte bënë të domosdoshëm angazhimin e NATO-s në zgjidhjen e krizës.¹³

Rol të rëndësishëm në rivendosjen dhe ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Ballkan ka luajtur edhe bashkëpunimi mjaft efektiv NATO - OSBE: në cilësinë e saj si forum i vetëm që i bashkon të gjitha vendet e Evropës bashkë me Kanadanë e SHBA-në. OSBE dhe NATO kanë punuar ngushtësisht si pjesë e përpjekjeve ndërkombëtare për vendosjen e paqes në ish-Jugosllavi. Në mënyrë të veçantë, marrëdhënie të ngushta kanë ekzistuar ndërmjet OSBE-së dhe IFOR-it, i cili më pas u shndërrua në SFOR, në Bosnje e Hercegovinë, si dhe ndërmjet OSBE-së dhe KFOR-it në Kosovë.¹⁴

Kërkime dhe Zhvillime të Politikave, Rr. Rexhep Mala, Nr. 5A 10 000 Prishtinë, Kosovë, f, 54.

¹¹ Lisen Bashkurti. Mbi të Drejtën Ndërkombëtare dhe Organizatat Ndërkombëtare, Akademia Diplomatike Shqiptare, GEER, Tiranë, 2006, f, 169.

¹² Nano Ruzhin, NATO në marrëdhëniet ndërkombëtare bashkëkohore, Shkup, f, 47.

¹³ Bejtush Gashi, Pjetër Hidri, Konfliktet ndërkombëtare dhe ndëretnike, Prishtinë, 2008, f, 59.

¹⁴ Gzim Rushiti, Bashkëpunimi OKB - NATO ne ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Ballkan, Punim për mbrojtjen e temës së Masterit, Fakulteti Juridik, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë, 2016, f, 31.

Roli i NATO-s në zgjidhjen e konfliktit të Bosnjës

Konflikti dhe mungesa e stabilitetit në Ballkan në vitet 1990, mbartte në vetvete sfida të drejtpërdrejta ndaj interesave të sigurisë së vendeve anëtare të NATO-s dhe më gjerë. Këto sfida dobësonin paqen dhe stabilitetin në Evropë.¹⁵ Përfshirja ushtarake perëndimore në konflikt nisi shpejt. Kur shpërtheu lufta, NATO-ja dërgoi në Bosnjë një kontigjent prej rreth 10 mijë vetash për të vendosur selinë qendrore në Kiseljak, jo larg nga luftimet e Sarajevës.

Me sa duket planifikuesit e NATO-s kishin si synim të krijonin një prani domethënëse në ish-Jugosllavi e kësisoj pritnin, në të vërtetë shpresonin, që roli i tyre në rajon të rritej.¹⁶ Forcat e Kombeve të Bashkuara u zëvendësua në vitin 1995 nga Forca e Implementimit e udhëhequr nga NATO (IFOR), e cila kishte autoritetin dhe aftësinë të zbatonte masat imponuese të autorizuar nga Kombet e Bashkuara. IFOR ishte përgjegjëse për imponimin e zonave të ndarjes, lejimin e lëvizjes së lirë të qytetarëve, largimin e forcave të huaja, negocimin e marrëveshjeve lokale për kontrollin e armëve dhe bashkëpunimin me Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve që hetonte krimet e luftës në rajon. Pas vitit 1996, IFOR u zëvendësua nga Forca Stabilizuese e NATO-s (SFOR). SFOR ngarkohet me zbatimin e paqes, administrimin e zgjedhjeve dhe mbështetjen e organizatave ndërqeveritare në rajon.¹⁷

Me kthimin e sigurisë në këtë vend, personeli i forcave të armatosura u pakësua dalëngadalë derisa SFOR-i e përfundoi misionin e tij në fund të vitit 2004. Më 2 dhjetor 2004, përgjegjësia kryesore për forcimin e paqes në këtë vend u mor nga misioni ushtarak i Bashkimit Evropian (EU) i quajtur Althea. Duke synuar sigurimin e një kalimi të butë ndërmjet forcave paqeruajtëse dhe një bashkërendim më të mirë me BE-në, NATO e ruajti praninë e saj në Bosnjë e Hercegovinë me Shefin e Shtabit të saj në Sarajevë.¹⁸

¹⁵ Manual i NATO-s, Public Diplomacy Division NATO 1110 Brussels, Belgium, ISBN 92-845-0180-6, HB-ALB-0406, NATO 2006, f. 253.

¹⁶ William Blum, CIA dhe ushtria amerikane, Tiranë, 2005, f. 589.

¹⁷ Karen A. Mingst, Bazat e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Albanian Institute for International Studies (AIIS), Tirana, 2008, f. 265

¹⁸ NATO vështruar në mënyrë të përmbledhur, Nisma për Edukim Euroatlantik 91, Vasil Levski BLVD., Sofia 1000, Bulgaria, f. 22

Roli i NATO-s në Kosovë

Historia e gjenocidit serb kundër popullsisë shqiptare të Kosovës ka një histori të gjatë. Në Jugosllavinë (ish-RSFJ) e paraluftës kundrejt Kosovës, me shumicë dërmuese shqiptare, u ndoq sistematikisht një politikë represioni, mohimi i çdo të drejte kombëtare dhe spastrimi etnik.¹⁹ Pas çlirimit nga pushtuesit nazistë, kur edhe në Kosovë e në viset e tjera shqiptare duhej të vendosej pushteti popullor dhe të shijohej liria, aty depërtuan njësitë serbo-malazezo-maqedonase, të cilat ushtruan dhunë, terror e gjenocid mbi popullin shqiptar. Gjenocidi serb në Kosovë u riintensifikua që nga vjeshta e vitit 1944.²⁰ Në thelb Kosova u vu nën një regjim okupimi ushtarak. Institucionet kryesore të krahinës u suprimuan. Kuvendi, Qeveria, Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve u shpërndanë. Këto zhvillime tregonin qartë se Beogradi po vihet në rrugën e shkeljeve të rënda e sistematike të të drejtave elementare kombëtare të shqiptarëve duke shpërfillur standardet e reja të së Drejtës Ndërkombëtare.²¹ Konflikti në Kosovë duhet kuptuar edhe në kontekstin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Kosova ishte një nga njësitë përbërëse të Jugosllavisë, me statusin e krahinës autonome. Heqja e autonomisë së Kosovës dhe Vojvodinës, ishte moment kyç në një vargan ngjarjesh që shpinë drejt kërkesave pavarësi nga republikat e tjera, si dhe drejt luftërave në këto republika, dhe së fundi edhe në vetë Kosovë.²² Në dhjetor 1997, ministrat e jashtëm të NATO-s deklaruan se interesi i aleancës në stabilitetin e Ballkanit nuk qëndron vetëm në Bosnjë e Hercegovinë, por në të gjithë rajonin dhe shprehën shqetësimin për rritjen e dhunës etnike në Kosovë.

Më 28 maj 1998, Këshilli i Atlantikut të Veriut, nëpërmjet Ministrave të Jashtëm e shtroi problemin në dy plane: së pari, u bënë thirrje të gjitha palëve për të gjetur një zgjidhje paqësore të krizës; dhe së dyti, u angazhuan për sigurimin e stabilitetit e të sigurisë në vendet fqinje, me theks të

¹⁹ Arben Puta, E Drejta Ndërkombëtare Publike. Botimi i dymbëdhjetë. Shtypshkronja "Guttenberg", ISBN 978-99943-0-160-7. Tiranë, 2010, f. 290.

²⁰ Historia e popullit shqiptar, Për shkollat e mesme. Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1996, f. 225.

²¹ Arben Puta, E Drejta Ndërkombëtare Publike. Botimi i dymbëdhjetë. Shtypshkronja "Guttenberg", ISBN 978-99943-0-160-7. Tiranë, 2010, f. 292.

²² Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave. Seria e kërkimeve politike. Botim i veçantë. Raporti kosovar, Konflikti, Reagimi ndërkombëtar, Leksionet e mësuara, Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën. Prishtinë, Qershor, 2005, f. 25.

veçantë në Shqipëri dhe Maqedoni.²³ Më 23 mars, Hollbruku iku nga Beogradi pa marrë ndonjë konsensus nga Millosheviçi, Solana urdhëroi Gjeneralin Klark të fillonte operacionin “Forca Aleate” mbi ish-Jugosllavi.²⁴

NATO e përdori ndërhyrjen ushtarake si mjetin e fundit në Kosovë pas një viti dhune që përshkallëzohej dhe shpërfilljeje këmbëngulëse nga regjimi i Beogradit të rezolutës së Këshillit të Sigurisë së OKB-së e cila kërkonte ndalimin e shtypjes së popullsisë shqiptare të kësaj zone. Pasi i shteroi të gjitha mjetet diplomatike dhe pas dështimit të vazhdueshëm të bisedimeve për paqe, në mars të vitit 1999, Aleanca vendosi të nisë sulmin ajror kundër strukturave ushtarake e paraushtarake të qeverisë jugosllave.²⁵ Këto marrëdhënie u zhvilluan më tej pas luftës në Kosovë me zbarkimin e misionit paqeruajtës ushtarak të NATO-s në Kosovë (KFOR) nën administratën ndërkombëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Që nga ajo kohë, KFOR-it i ishte dhënë roli kryesor në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes në Kosovë. Misioni i saj buron nga Marrëveshja teknike dhe ushtarake (e njohur ndryshe edhe si Marrëveshja e Kumanovës), e cila ishte nënshkruar më 9 qershor 1999 në mes të NATO-s dhe përfaqësuesve të ish-Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ). Marrëveshja e Kumanovës kishte shërbyer si njëra nga kornizat juridike për Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (KSOKB), e cila është baza kryesore juridike për praninë e misionit të KFOR-it në Kosovë. Marrëveshja e Kumanovës kishte paraparë vendosjen e KFOR-it pa asnjë pengesë në tërë territorin e Kosovës me qëllim të vendosjes dhe ruajtjes së ambientit të sigurt për të gjithë qytetarët e Kosovës.²⁶

Mandati i KFOR-it vjen nga një marrëveshje ushtarake teknike nënshkruar nga komandantët e NATO-s dhe ata jugosllavë si dhe nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të dyja në qershor 1999. Pra KFOR përgjigjet për shmangien e rigjallërimit të konfliktit, ndërtimit të një ambienti të sigurt dhe demilitarizimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjithashtu, forca e udhëhequr nga NATO mbështet

²³ Pajtim Ribaj, Shpëtim Çami, Lufta, Paqja, Siguri-Realitete Ballkanike, Botimet M&B, Tiranë, 2015, f, 398.

²⁴ Pajtim Ribaj, Shpëtim Çami, Lufta, Paqja, Siguri-Realitete Ballkanike, Botimet M&B, Tiranë, 2015, f, 401.

²⁵ NATO vështruar në mënyrë të përmbledhur, Nisma për Edukim Euroatlantik 91, Vasil Levski BLVD., Sofia 1000, Bulgaria, f, 22.

²⁶ Destinacioni në NATO “ Alternativat e Kosovës drejt anëtarësimit në NATO”, Dokument i Politikave nga QKSS, Maj, 2015, f, 13.

përpjekjet humanitare ndërkombëtare dhe punon së bashku me prezencën ndërkombëtare civile, Misionin e Administrimit të Përkohshëm të OKB-së në Kosovë (UNMIK), për të krijuar një ambient të sigurt për zhvillimin stabil të provincës.²⁷

Analiza e sfondit historik të rolit të NATO-s në Kosovë ka rëndësi jo vetëm historike njohëse, por para së gjithash për të kuptuar rolin dhe karakterin e NATO-s, misionin dhe aftësinë e saj implementuese. Pa NATO-n, as parimet universale të Kartës së San Franciskos, as parimet euro-atlantike të Helsinkit, as paqja e stabiliteti në Ballkan dhe as zgjidhjet e mëtutjeshme nuk do të mund të arriheshin. Këtu qëndron principaleteti i lartë i NATOS-s si dhe vendi e rëndësia historike e saj për sot e për të ardhmen.²⁸

Relacionet e NATO-s me Republikën e Maqedonisë së Veriut

Republika e Maqedonisë në bazë të nenit 121 të Kushtetutës së RM-së, në mbledhjen e Kuvendit të mbajtur me datë 23 dhjetor të vitit 1993 ka miratuar vendim për anëtarësimin e RM-së në Organizatën Veri-Atlantike. Me vendim të Kuvendit të RM-së, Kryetari i shtetit e parashtrroi kërkesën zyrtare për anëtarësim.

Më 23 dhjetor të vitit 1993, Kuvendi i RM-së solli vendim për anëtarësimin në NATO, ndërsa më 15 nëntor të vitit 1995 si shtet i 27 qaset në Programin e Partneritetit për Paqe dhe bëhet anëtare e Këshillit për Bashkëpunim të Atlantikut të veriut. Duhet të theksohet që anëtarësimi në Programin e Partneritetit për Paqe ishte e kushtëzuar me anëtarësimin paraprakë të OSBE-së, që shpesh herë ishte i bllokuar për shkak të kontestit të pazgjidhur me fqinjin jugor. Më 14 qershor të vitit 1996 në Bruksel, në selinë e NATO-s u hap zyra maqedonase për lidhje. Më 15-18 janar të vitit 1997 RM-ja zyrtarisht është anëtarësuar në Komitetin për analizën dhe planifikimin ushtarak, që paraqet shkallë të lartë të bashkëpunimit me Aleancën Veri-Atlantike.²⁹ Me kërkesën e autoriteteve të Shkupit, NATO u përfshi në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë për të ndihmuar në sheshimin e konfliktit që po rritej midis qeverisë dhe kryengritësve etnikë shqiptarë. Kjo bëhej me synimin që të parandalohet

²⁷ NATO në shekullin e XXI, NATO Public Diplomacy Division, 1110 Brussels, Belgium, f. 17.

²⁸ Lisen Bashkurti. Mbi të Drejtën Ndërkombëtare dhe Organizatat Ndërkombëtare, Akademia Diplomatike Shqiptare, GEER, Tiranë, 2006, f. 167.

²⁹ Drita M. Fazlia, Organizatat ndërkombëtare, Tetovë, 2014, f. 219

ajo gjendje që mund të shndërrohej në luftë të një shkalle të gjerë.³⁰ Nëpërmjet një operacioni 30 ditor, 3500 ushtarë të NATO-s arritën të konfiskojnë 4000 armë. Ky operacion ndihmoi për të shmangur përshkallëzimin e një konflikti civil të armatosur dhe përgatiti kushtet e nevojshme për pajtimin e riorganizimin e vendit.³¹ Me kërkesë të Shkupit, trupat e NATO-s ngelën në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë duke ofruar dhe garantuar mbrojtje për vëzhguesit nga Bashkimi Evropian dhe Organizata për Sigurim e Bashkëpunim në Evropë, deri në mars të vitit 2003, kur misioni u mor përsipër nga Bashkimi Evropian.³²

Karta e Adriatikut, Samiti i Bukureshtit dhe Republika e Maqedonisë

Iniciativa e Kartës së Adriatikut erdhi si domosdoshmëri dhe mbështetje e palës amerikane në rrugën e integritit në NATO. Në këtë iniciativë bëjnë pjesë Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia (anëtarësuar në vitin 2003), Bosnja e Hercegovina dhe Mali i Zi (anëtarësuar në vitin 2010), ndërsa Kosova dhe Serbia kanë statusin e vëzhguesit. Karta e Adriatikut u nënshkrua në Tiranë, në 2 Maj 2003 në praninë e ministrave të jashtëm të tre vendeve dhe SHBA-s.³³

Samiti i Bukureshtit i vitit 2008 shtroi nevojën e draftimit të një “Koncepti të ri strategjik”. Në këtë samit u diskutua edhe për çështjen e zgjerimit të kësaj aleance, gjegjësisht anëtarësimin e vendeve të Kartës së Adriatikut.³⁴ Në Samitin e NATO-s të mbajtur në Bukuresht, liderët aktualisht refuzuan të dërgojnë ftesë për anëtarësim në Aleancë pasi që Greqia e bllokoi vendimin për shkak të emrit të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Sekretari Gjeneral i NATO-s, Jan De Hop Shefer në konferencën për shtyp tha: “Ne u pajtuam që ftesa t’i dërgohet

³⁰ Manual, NATO Public Diplomacy Division, 1110 Brussels, Belgium, f. 161

³¹ NATO vështruar në mënyrë të përmbledhur, Nisma për Edukim Euroatlantik 91, Vasil Levski BLVD., Sofia 1000, Bulgaria, f. 24

³² NATO në shekullin e XXI, NATO Public Diplomacy Division, 1110 Brussels, Belgium, f. 17

³³ Kolonel (rez) Dr. Çlirim Toçi, Arti i Diplomacisë Ushtarake dhe Mjedisi i ri i Sigurisë, Tiranë, Shqipëri, f. 102.

³⁴ Perspektivat Euro-Atlantike të RM-së: Problemet, Sfidat dhe realiteti politik pas dështimit në samitin e NATO-s në Bukuresht 2008, Referate të prezentuara në Konferencën shkencore të mbajtur në UEJL më datë 2 Maj 2009, Qendra për Hulumtime të Administratës Publike, f. 136

ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë menjëherë pasi që të arrihet zgjidhje e përbashkët e pranueshme për çështjen e emrit.³⁵

Republika e Maqedonisë së Veriut dhe anëtarësimi në NATO

Më 11 korrik 2018, në Samitin e NATO-s në Bruksel, Republika e Maqedonisë u ftua zyrtarisht të fillojë negociatat e anëtarësimit për anëtarësimin në NATO. Më 19 korrik 2018, Parlamenti i Republikës së Maqedonisë në sesionin e tij të 57-të miratoi Deklaratën në mbështetje të procesit të anëtarësimit për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në NATO. Më 18-19 tetor 2018, në një takim në Bruksel, zyrtarisht përfunduan bisedimet e pranimit midis Republikës së Maqedonisë dhe NATO-s. Më 6 shkurt 2019, përfaqësuesit e përhershëm të 29 vendeve anëtare të NATO-s në Selinë e NATO-s nënshkruan protokollin e pranimit për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO. Me nënshkrimin e Protokollit të Anëtarësimit, fillon faza tjetër e procesit të pranimit, e cila pasohet nga ratifikimi i Protokollit nga parlamentet kombëtare dhe institucionet e vendeve anëtare të Aleancës. Më 11 shkurt 2020, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut ratifikoi Protokollin e Anëtarësimit në NATO. Pa vota kundër dhe abstenim, 114 deputetë votuan “pro” anëtarësimit të vendit tonë në Aleancën e Atlantikut të Veriut. Më 12 shkurt 2020, Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, nënshkroi Dekretin për shpalljen e Ligjit për Ratifikimin e Traktatit të Atlantikut të Veriut. 20 Mars 2020, Presidenti Pendarovski nënshkroi Instrumentin për Aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Aleancën e Atlantikut të Veriut.³⁶

Më 27 mars 2020, Republika e Maqedonisë së Veriut u bë shteti i tridhjetë anëtar i Aleancës. Kështu, realizohet një nga tre përparësitë strategjike të politikës së jashtme të vendit, rreth të cilit u ndërtua konsensusi më i gjerë politik, i ndjekur nga mbështetja e fortë e qytetarëve të vendit.³⁷

³⁵ Veto e Maqedonisë, fitore e nacionalizmit grek dhe si më tutje, Analizë e shkurtër nr.17, Qendra për Hulumtim dhe Krijim të Politikave, Prill, Shkup, 2008, f, 3

³⁶ <https://nejeminato.mk/rruga-drejt-nato-s/>

³⁷ <https://mfa.gov.mk/sq/page/7/an%C3%ABtar%C3%ABsimi-n%C3%AB-nato>

Conclusion

The creation of the North Atlantic Alliance and Europe's permanent security link with North America represents a vital step for the security of the continent of Europe.

The Balkan Peninsula is a geopolitical and cultural region of Southeast Europe, which takes its name from the Balkan Mountains that stretch from central Bulgaria to eastern Serbia. The relations and importance of the Balkan Peninsula for NATO is of special importance, and this is evidenced by the fact that the first enlargement of the North Atlantic Alliance took place in the direction of the two Balkan states, Turkey and Greece in 1952. NATO intervention in the Balkan crisis enabled the establishment of peace in the war-torn region of the late twentieth century, as well as the prohibition of ethnic cleansing, the prohibition of further violations of fundamental human rights and the prohibition of further genocide by the Yugoslav army on the civilian population in the states emerging from the former SFRY.

Recensentë:

Prof. Dr. Nazmi Maliqi

Prof. Dr. Afrim Osmani

Literatura

1. Arben Puta, E Drejta Ndërkombëtare Publike. Botimi i dymbëdhjetë. Shtypshkronja "Guttenberg", ISBN 978-99943-0-160-7. Tiranë, 2010
2. Arif Riza, E drejta e organizatave ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare, Botimi I, Prishtinë, 2012
3. Bejtush Gashi, Pjetër Hidri, Konfliktet ndërkombëtare dhe ndëretnike, Prishtinë, 2008
4. Drita M. Fazlia, Organizatat Ndërkombëtare, Arbëria Design-Tetovë, Tetovë, 2014
5. Gjorgji Tonovski. Organizatat Ndërkombëtare, Universiteti Evropian - RM, Shkup, Fakulteti i Shkencave Juridiko - Politike, Shkup, 2006
6. Historia e popullit shqiptar, Për shkollat e mesme. Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1996
7. Karen A. Mingst, Bazat e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Albanian Institute for International Studies (AIIS), Tirana, 2008

8. Lisen Bashkurti. Mbi të Drejtën Ndërkombëtare dhe Organizatat Ndërkombëtare, Akademia Diplomatike Shqiptare, GEER, Tiranë, 2006
9. Nano Ruzhin, NATO në marrëdhëniet ndërkombëtare bashkëkohore, Shkup
10. Pajtim Ribaj, Shpëtim Çami, Lufta, Paqja, Siguri - Realitete Ballkanike, Botimet M&B, Tiranë, 2015
11. William Blum, CIA dhe ushtria amerikane, Tiranë, 2005
12. Gzim Rushiti, Bashkëpunimi OKB - NATO ne ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Ballkan, Punim për mbrojtjen e temës së Masterit, Fakulteti Juridik, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë, 2016
13. Kolonel (rez) Dr. Çlirim Toçi, Arti i Diplomacisë Ushtarake dhe Mjedisi i ri i Sigurisë, Tiranë, Shqipëri
14. Destinacioni në NATO “Alternativat e Kosovës drejt anëtarësimit në NATO”, Dokument i Politikave nga QKSS, Maj, 2015
15. Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave. Seria e kërkimeve politike. Botim i veçantë. Raporti kosovar, Konflikti, Reagimi ndërkombëtar, Leksionet e mësuara, Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën. Prishtinë, Qershor, 2005
16. Lulzim Peci, Kosova në kontekstin e sigurisë dhe të mbrojtjes të Ballkanit Perëndimor, Punim i politikave, Nr. 3/14 - Shtator 2014, KIPRED, Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave, Rr. Rexhep Mala, Nr. 5A 10 000 Prishtinë, Kosovë
17. Manual i NATO-s, Public Diplomacy Division NATO 1110 Brussels, Belgium, ISBN 92-845-0180-6, HB-ALB-0406, NATO 2006
18. NATO vështruar në mënyrë të përmbledhur, Nisma për Edukim Euroatlantik 91, Vasil Levski BLVD., Sofia 1000, Bulgaria
19. NATO në shekullin e XXI, NATO Public Diplomacy Division, 1110 Brussels, Belgium
20. Perspektivat Euro-Atlantike të RM-së: Problemet, Sfidat dhe realiteti politik pas dështimit në samitin e NATO-s në Bukuresht 2008, Referate të prezentuara në Konferencën shkencore të mbajtur në UEJL më datë 2 Maj 2009, Qendra për Hulumtime të Administratës Publike
21. Traktati i Atlantikut të Veriut, Uashington D.C., 4 prill 1949
22. Veto e Maqedonisë fitore e nacionalizmit grek dhe si më tutje, Analizë e shkurtër nr.17, Qendra për Hulumtim dhe Krijim të Politikave, Prill, Shkup, 2008
23. <https://nejeminato.mk/rruga-drejt-nato-s/>
24. <https://mfa.gov.mk/sq/page/7/an%C3%ABtar%C3%ABsimin%C3%AB-nato>